



Asociacioni i Komunave të Kosovës

R A P O R T

nga

Takimi i Kolegjiumit për Arsim dhe Kulturë

Prishtinë, 4 shkurt 2010

Për: Ertan Munoglu – Menaxher i Programit i AKK-së

Nga: Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjumeve të AKK-së

Lënda: Raport nga takimi i Kolegjiumit për Arsim dhe Kulturë



4 shkurt 2011, Villa Gërmia, Prishtinë

HYRJE

Asociacioni Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me Kryesinë e Kolegjiut për Arsim dhe Kulturë organizoi takimin e radhës së këtij Kolegjiut me 4 shkurt 2011 në Restorantin "Villa Gërmia" në Prishtinë.

Takimi kishte për qëllim të diskutohej rendi i ditës i përcaktuar më parë nga Kryesia me këto pika:

- Raporti i punës së Kolegjiut qershor-dhjetor 2010 dhe Plani i punës për janar-qershor 2011,
- Analiza e suksesit të gjysmë-vjetorit të parë të vitit shkollor 2010/11,
- Gjendja aktuale në arsimin para-universitar dhe hapat e mëtejme,
- Formula e re e financimit, dhe
- Provimi shtetëror i maturës.

Në këtë takim morën pjesë Drejtorë të Drejtorive Komunale për Arsim dhe Kulturë të Kosovës, përfaqësues nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe përfaqësues të AKK. Takimi u kryesua nga Kryesuesi i Kolegjiut për Arsim dhe Kulturë z. Azem Guri.

PËRMBLEDHJE

z. Azem Guri, Kryesues i Kolegjiut – në fjalën hyrëse falënderoj AKK-në për organizimin e këtij takimi dhe poashtu falënderoj të gjithë për pjesëmarrje në këtë takim, dhe pastaj dha fjalën z. Ertan Munoglu, Menaxher i Programit në AKK.

z. Munoglu kërkoi nga Kolegjiut përpilimin e Planit të Punës për vitin 2011 dhe unifikimin e formatit të Planit me të gjitha Kolegjiut tjera. Gjatë vitit të kaluar është kryer një studim nga GTZ për punën e kolegjiutëve, andaj në vazhden e përmirësimit të punës së kolegjiut AKK ka përgatitur një dokument udhëzues për përpilimin e planit të punës së kolegjiut i cili përmban pikat kryesore të strategjisë së AKK për periudhën 2011-2015, prioritetet e Kolegjiut për vitin 2010 si dhe tabelën e punës për vitin 2011.

z. Guri prezantoi rendin e ditës, dhe pas miratimit të rendit të ditës me unanimitet vazhdoi me pikën e parë:

1. Raporti i punës së Kolegjiut qershor-dhjetor 2010 dhe Plani i punës për janar-qershor 2011

z. Guri prezantoi punën e Kolegjiut për periudhën janar-qershor 2011 sipas **Aneksit 1** të bashkangjitur në këtë raport.

Pasi që të pranishmit nuk kishin vërejtje rreth formatit të Planit të Punës 2011, z. Guri theksoi se Kryesia e Kolegjiut do të takohet së shpejti dhe të përpiloj Planin në fjalë.

z. Nexhat Çoçaj, Drejtor i Arsimit në Komunën e Prizrenit - kërkoi që qëndrimet dhe informatat tjera relevante të Kolegjiut të përcillen me shkrim të pjesëmarrësit, përfshirë edhe planin me objektivat e punës, në mënyrë që të gjithë të jenë të informuar paraprakisht për punën e mëtutjeshme të Kolegjiut, gjë që u shënuar nga z. Guri dhe që do të adresohet në të ardhmen.

z. Arsim Mehmeti, Drejtor i Arsimit në Komunën e Drenasit – kërkoj informim më të mirë rreth punës së Kolegjiumit dhe një raport më detaj rreth punës njëvjeçare të Kolegjiumit ku do të nxirreshin konkluzat/rekomandimet si dhe realizueshmëria e tyre (p.sh. cila rekomandime kanë pasur sukses, cilat konkluzione nuk janë mirëpritur prej Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë) në mënyrë që të ballafaqohemi me raportin e aktiviteteve dhe punës së Kolegjiumit. z. Guri theksoi se të gjitha të dhënat ekzistojnë dhe një raport i tillë do të prezantohet në takimin e radhës.

2. Analiza e suksesit të gjysmë-vjetorit të parë të vitit shkollor 2010/11,

z. Qerim Selimi, zv. kryesuesit i Kolegjiumit - prezantoi raportin e analizës së suksesit të gjysmë-vjetorit të parë të vitit 2010/2011, bazuar në statistikat e marra nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në nivel vendi dhe për secilën Komunë. z. Selimi paraqiti shifrat krahasuese të suksesit mes gjysmë-vjetorit të parë 2010/2011 me atë 2009/2010 për nivelin 1 (klasat I-V), 2 (klasat VI-IX), dhe 3 (klasat X-XII) ku rezultati i përafërt mesatar arrin si në vijim: niveli 1 – 95%, niveli 2 – 72 %, dhe niveli 3 – 39 %. Në përgjithësi mund të thuhet se është një rezultat përafërsisht i njëjtë sikurse vitet e kaluara (me rënie apo ngritje në komuna të veçanta) që mesatarisht sillet rreth 70%. Mirëpo a është ky një vlerësim real i gjendjes? A është ky sukses rezultat i qasjes së mos-ngeljes së nxënësve apo efikasitetit mësimor? Njëkohësisht u prezantuan edhe krahasimet e suksesit mes gjysmë-vjetorit të parë dhe të dytë të vitit shkollor 2009/2010, ku u veçua dallimi i theksuar i suksesit mes gjysmë-vjetorëve. Mbetet të identifikohet se cilat janë arsyet që nxënësit arrin sukses shumë më të dobët në gjysmë-vjetorin e parë krahasuar me atë të dytin; a është në pyetje kushtëzimi i nxënësve për çështje disiplinore apo nxitja e nxënësve të ndjekin kurse private tek arsimtarët e njëjtë të cilët kështu sigurojnë të ardhura shtesë? Krahasimet mes shkollave në gjuhën shqipe dhe atyre serbe treguan se këto të fundit kanë sukses që shkon deri në 100%. Të dhënat e mungesave të paarsyeshme të nxënësve në shkolla janë alarmante dhe nxisin debat se cilat duhet të ishin masat disiplinore konkrete për t'u ndërmarrë?

Për me shumë informata rreth të dhënave të prezantuara, shih **Aneksin 2** të këtij raporti.

z. Çoçaj kërkoj të publikohen rezultatet e testit të klasës V, dhe cekim se dobësitë tek testi i arritshmërisë në nivelin 2 vijnë nga niveli i dobët i mësimin në nivelin 1. Ekziston përshtypja se për shkak të mos-ngeljes së nxënësve të dobët po krijohen analfabet, dhe prandaj është i nevojshëm klasifikimi i nxënësve në nivelin 2. Ndërsa tek çështja e mungesave saktësoi se duhet të ndryshohet Udhëzimi Administrativ (UA) i cili nuk lejon përjashtimin e nxënësve si masë disiplinore. Sipas UA, pezullimi i nxënësve nga shkolla për më shumë se një muaj bëhet nga Kuvendi Komunal, i cili si organ politik ka prioritete tjera dhe jo çështjen e nxënësve individual. Komuna e Prizrenit ka hartuar një rregullore për masat disiplinore të cilën kërkohet që ta nënshkruajnë edhe prindërit para regjistrimit të nxënësve në ditarë ku në rast të shkeljes së rregullores ata mbajnë përgjegjësi personale; dhe deri më tash kjo është reflektuar pozitivisht. z. Çoçaj po ashtu theksoj se një tjetër problem është se ditarët nuk kanë hapësirë për regjistrimin e nxënësve alternativ, gjë që kërkohet me UA.

z. Agim Berisha, Drejtor i Arsimit në Komunën e Ferizajit - theksoi se prezantimi do duhej të përfshinte edhe një pasqyrë të mungesave të mësimdhënësve, sepse ka raste kur më shumë mungojnë mësimdhënësit sesa nxënësit. Në parandalimin e këtyre dukurive negative duhet të fuqizohet zyra e Inspektoratit (p.sh. 5 inspektorë për 6 komunat e rajonit të Ferizajit nuk mjaftojnë), dhe duhet të bëhen

hospitime më të shpeshta gjatë orarit të mësimit në mënyrë që të shtohet kontrolli i punës. Gjithashtu përmendi se duhet ndryshuar ose plotësuar UA nga MASHT-i, dhe se konkurset për pranimin e nxënësve në shkolla të mesme duhet të jenë specifike për ç'do shkollë sepse kushtet dhe mundësitë dallojnë nga komuna në komunë (p.sh. përderisa klasat në një komunë kanë nga 40 nxënës, ato në një komunë tjetër mund të kenë vetëm 33). Një problem tjetër me theks të veçantë është regjistrimi i nxënësve nëpër gjimnaze, ku për shkak të ndërhyrjes politike rritet numri i nxënësve në klasë dhe përmbysen të gjitha kriteret e pranimit në shkolla.

z. Xhemajl Shala, Drejtor i Arsimit në Komunën e Suharekës – sugjeroi se çelësi i suksesit është tek ndërtimi i raportit nxënës-mësimdhënës, i cili duhet të matet përmes vlerësimit të ndërsjellë, ndërsa Drejtorët e shkollës duhet të raportojnë për punën e mësimdhënësve në Bordin e Drejtorëve të Komunës. Këshillat e shkollave poashtu duhet të forcohen dhe t'i kundërvihen drejtorëve të shkollave të cilët për shkak të fuqisë së perceptuar të tyre shpërfillin anëtarët tjerë të bordeve në shkolla. Futja e përfaqësuesve të biznesit në këto borde do të stimulonte nxënësit përmes bursave të ndryshme, sikur në rastin e Suharekës.

z. Mustafë Kadriu, Udhëheqës i Njësisë për Standarde dhe Vlerësime në MASHT - potencoj se rezultatet janë të pakënaqshme dhe se duhet të ketë një qasje më serioze në vlerësimin e nxënësve, sepse suksesi mes gjysmë-vjetorëve dallon shumë. Sa i përket testeve të klasës V, ato do të publikohen për tre vitet e kaluara, ku rezultatet kanë përmirësim nga viti në vit: derisa rezultatet e vitit 2008 ishin të turpshme, suksesi i vitit 2009 ishte rreth 34% ndërsa ai i vitit 2010 ishte rreth 50%. Për MASHT mbetet brengosëse menaxhimi dhe administrimi i testeve të klasave IX, të cilat në prezencë të mësimdhënësve tregojnë rezultate të fryera. MASHT ka bërë një studim përmes një testi të dyfishtë: një herë i zbatuar nga Ministria dhe një herë nga komuna, dhe rezultatet dallojnë shumë, prandaj ekzistojnë dyshimet tek procesi i administruar nga komunat. Vlerësimi i brendshëm duhet të jetë më realist sepse është vërejtur se në disa raste ka diferenca shumë të mëdha, ku notimi bëhet ose me notën më të lartë ose atë më të dobët. Një çështje tjetër që MASHT-i kërkon është edhe përzgjedhja e nxënësve me talente dhe ata me nevoja të veçanta me qëllim të avancimit të tyre.

z. Arsim Mehmeti, Drejtor i Arsimit në Komunën e Drenasit - konsideron se problemi qëndron te mësimdhënësit për shkak të mos-vlerësimit adekuat të tyre, si dhe për arsye se suksesi i nxënësve bie kur kalojnë nga një nivel në tjetrin. Për këtë arsye drejtorët duhet të hospitojnë në klasë për të vëzhguar punën e mësuesit; i njëjti mësimdhënës duhet të mbajë klasën deri në klasën V, dhe testet e klasës V janë të domosdoshme në mënyrë që të përcillet suksesi i mësimdhënësve prej fillimit deri në fund. Në anën tjetër, UA duhet të ndryshoj për të forcuar masat disiplinore sepse Kuvendet Komunale anulojnë pezullimin e nxënësve problematik të cilët kthehen në shkollë si hero. Kurse bordi i shkollës duhet të luaj një rol më të fuqishëm për shkollën.

Si rezultat i këtij diskutimi, z. Mehmeti dha këto rekomandime:

1. kriteret për regjistrim në shkolla të aplikohen në tërësi
2. Vlerësimi i mësimdhënësve është i domosdoshëm
3. Hospitimi gjatë orëve të mësimit është i domosdoshëm

4. Të sanksionohen mungesat e mësimitdhënësve
5. Testi për klasat V është i domosdoshëm
6. Nevojitet një Kod i Mirësjelljes për mësimitdhënësit nga MASHT, sepse ai i Shërbimit civil nuk mjafton
7. MASHT duhet të trajnoj mësimitdhënësit për vlerësim.

z. Shala shtoi se MASHT duhet të rregulloj orët private të cilat mbahen nëpër shtëpi të mësimitdhënësve.

Zyrtari për Financa në Komunën e Pejës – theksoi se duhet shqyrtuar edhe çështjen e dallimit në rroga mes edukatorëve në çerdhe dhe arsimtarëve.

3. Gjendja aktuale në arsimin para-universitar dhe hapat e mëtejme

Për shkak të interesimit të madh për të diskutuar pikën 2 të rendit të ditës, kjo pikë është shtyrë për takimin e radhës të Kolegjiut.

4. Formula e re e financimit, dhe

Për shkak të interesimit të madh për të diskutuar pikën 2 të rendit të ditës, edhe kjo pikë është shtyrë për takimin e radhës të Kolegjiut.

5. Provimi shtetëror i maturës

z. Nexhmi Rudari, Drejtor i Arsimit në Komunën e Podujevës – prezantoi raportin mbi gjendjen e provimit të maturës.

Provimi i maturës është organizuar mbi bazë të Ligjit nr. 03/L-018, por menaxhimi i tij nuk ka qenë i kënaqshëm dhe si pasojë nuk janë nxjerrë rezultate reale të shkallës së arritshmërisë së nxënësve në këtë nivel të shkollimit. Disa nga problemet e identifikuara në këtë fushë janë:

- Hulumtimet e pakta që janë bërë dëshmojnë se cilësia e mësimitdhënies dhe e vlerësimit në shkollat fillore dhe të mesme të Kosovës është e ulët.
- Testimi zakonisht organizohet në shkollë/klasë, ku në shumë raste mungon hapësira e mjaftueshme dhe komode për punë të papenguar.
- Deri më tani nuk është dëshmuar koordinim i mirë dhe i qëndrueshëm në mes MASHT-DKA dhe shkollës jo vetëm për organizimin e testit të maturës por edhe në eliminimin e pengesave që janë shfaqur në vitet paraprake.
- Komunat dhe shkollat tona nuk kanë dëshmuar kapacitete për menaxhimin dhe administrimin e testit, një ndërmarrje kaq e rëndësishme për sistemin e arsimit.
- Problem në vete paraqet edhe mungesa e sistemit dhe kriterëve për trajnimin e hartuesve dhe administruesve të testit të maturës, por edhe mungesa e trajnimit dhe licencimit të administruesve të testit të maturës. Administruesit caktohen *ad hoc* nga MASHT prej listave që i dërgojnë DKA-të dhe shkollat.
- Nuk është krijuar ndonjë sistem për informim të rregullt e të qëndrueshëm të nxënësve dhe të mësimitdhënësve për mënyrën e plotësimit të testit dhe të pikëzimit.

Si rezultat i gjithë kësaj, synim i përgjithshëm mbetet: Ndërtimi i një sistemi efikas të menaxhimit cilësor të provimit të maturës përmes programeve e masave efikase që përmirësojnë kapacitetet menaxhuese në këtë fushë.

Për informatat shtesë rreth prezantimit, shih **Aneksin 3** të këtij raporti.

z. Kadriu nga MASHT potencoi se ky është një proces i cili duhet të begatohet edhe më tutje, edhe pse disa nga çështjet që u ngritën për provimin e maturës nuk qëndrojnë. Testet përpilohen nga ekspertë (profesorë nga universiteti si dhe nga shkolla të mesme) të fushave të ndryshme përmes grupeve punuese dhe i plotësojnë të gjitha standardet profesionale, edhe pse ka pasur ndryshime nga viti në vit në përputhje me nevojat. Nuk ka një administrim të kënaqshëm të testit të maturës sepse menaxhimi në përgjithësi është përgjegjësi kolektive, prandaj edhe humb përgjegjësia individuale. Por faji nuk është vetëm i Ministrisë, sepse një pjesë e përgjegjësive bartet tek Drejtoritë Komunale për Arsim (DKA), të cilat pastaj bartin një pjesë të përgjegjësive shkollave për administrim të testit. Gjithsesi DKA-të duhet të jenë më vigjilente dhe të përcaktojnë listat e administruesve dhe vëzhguesve të përgjeshëm dhe ndërgjegjshëm. MASHT ka shpërndarë fletushka dhe programe orientuese për testin një proces të gjërë duke përfshirë të gjitha palët, dhe informacioni nuk mund të thuhet se i mungon nxënësve. MASHT poashtu ka bërë të gjitha pagesat administruesve përveç në disa raste në mungesë të informacionit. Ndërsa planet për këtë vit pësojnë ndryshim sepse tani testi i maturës e zëvendëson provimin pranues për universitete.

PËRMBYLLJE

Për shkak të interesimit të madh dhe diskutimeve të ngjeshura, Kryesuesi në pajtim me të gjithë pjesëmarrësit potencoi se rekomandimet e këtij takimi do të nxirren në raport, dhe njëkohësisht caktoi takimin e radhës në mars ku do të diskutohen pikat 3 dhe 4 më lartë. Data dhe vendi (në ndonjë komunë tjetër) do të caktohen në ndërkohë, dhe paraprakisht Kryesia e Kolegjiutit së bashku me AKK do të përgatisin Planin e Punës për 2011.

Krejt në fund Kryesuesi falënderoj të gjithë për pjesëmarrje dhe kontributin në diskutime.

REKOMANDIMET

Masat rregullore

1. Kolegjiutit të bëjë rekomandime për ndryshim të Udhëzimit Administrativ të MASHT, në mënyrë që të forcohen masat disiplinore për nxënësit problematik
2. Të nxirret një Rregullore apo Kod i Mirësjelljes për mësime dhënësit dhe të sanksionohen mungesat e mësime dhënësit
3. Të rregullohet çështja e orëve private përmes akteve adekuate
4. MASHT të shpërndajë udhëzimet për konkurset e pranimit të nxënësve në shkolla të mesme individualisht për çdo komunë

Masat tjera

5. Kolegjiumi të informoj me shkrim qëndrimet dhe informatat tjera relevante tek të gjithë pjesëmarrësit
6. Kryesia e Kolegjiumit së bashku me AKK të përpiloj Planin e Punës për vitin 2011
7. Kolegjiumi të prezantoi në takimin e radhës një raport më detaj rreth punës gjatë vitit 2010 me konkluzat/rekomandimet dhe realizueshmërinë e tyre (sa prej tyre kanë pasur sukses e sa jo)
8. DAK-të të monitorojnë zbatimin e kriterëve për regjistrimin e nxënësve nëpër gjimnaze
9. DAK-të të fuqizojnë bordet e shkollave dhe të shqyrtohet mundësia për futjen e përfaqësuesve të biznesit në këto borde, sipas përvojës së mirë të Komunës së Suharekës. AKK të lehtësoj procesin e ndarjes së kësaj përvoje me të gjitha komunat tjera
10. DKA-të të përcaktojnë listat e administruesve dhe vëzhguesve të përgjegjshëm dhe ndërgjegjshëm
11. Komunat të fuqizojnë zyrat e inspektoratit dhe të bëhen hospitime më të shpeshta gjatë orarit të mësimit në mënyrë që të shtohet kontrolli i punës
12. DAK-të të obligojnë Drejtorët e shkollave të vlerësojnë punën e mësimeve dhe të raportojnë në Bordin e Drejtorëve të Komunës. Po ashtu të shqyrtohet mundësia e vlerësimit të mësimeve edhe nga nxënësit
13. DAK-të të kërkojnë nga shkollat përzgjedhjen e nxënësve talent dhe atyre me nevojë të veçanta dhe lista t'i drejtohet MASHT-it
14. MASHT së bashku me komunat të ndërtoj një sistemi efikas të menaxhimit cilësor të provimit të maturës
15. MASHT të publikoj rezultatet e testit të klasës V
16. MASHT të trajnoj mësimeve për vlerësim